



01 Nr. 443/24 Dt. 19.07.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 lidhur me nenin 18 paragrafi 1.7 i Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për Skender Krasniqin, nxënës i Gjimnazit “Gjon Buzuku” në Prizren, i cili përfaqëson Prizrenin dhe Republikën e Kosovës në Olimpiadën e 54 Ndërkombëtare të fizikës (IPHO 2024)-gara në fizikë, që do të mbahet nga data 21-29 korrik 2024 në Isfahan, Iran, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të motivimit dhe stimulimit, lejohen mjetet financiare në shumën prej 500 € (pesëqind euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurit,
 - Arkivës së Kryetarit.

